



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:030743

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05785670

C.nr.475/20

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.M., F.R., Z.K., Xh.S., B.M., B.S., A.R.1., A.R.2., B.R., A.Xh., D.Q., N.G., B.A., M.H., H.Rr., R.R., R.H., J.A., E.B., B.Ç., Xh.Q., V.I., F.J., F.S., T.I., M.M., M.U., H.O. dhe T.H., të cilët me autorizim i përfaqëson Av. H.Rr. nga Ferizaj, kundër të paditurve Komuna Ferizaj të cilën e përfaqëson i autorizuari Sami Vranovci dhe Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme e Kosovës, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, për shkak të mospërmbushjes së obligimeve nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe Vendimit të KK. Ferizaj 01.Nr.2889, vlera e kontestit 17288,00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik, me datë 05.06.2024 ka marrë këtë;

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve F.M., F.R., Z.K., Xh.S., B.M., B.S., A.R.1., A.R.2., B.R., A.Xh., D.Q., N.G., B.A., M.H., H.Rr., R.R., R.H., J.A., E.B., B.Ç., Xh.Q., V.I., F.J., F.S., T.I., M.M., M.U., H.O. dhe T.H. dhe **DETYROHET E PADITURA Qeveria e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme e Kosovës**, që paditësve të poshtëshënuar në emër të shpërblimit të pagës jubilarë të jau paguajë:

- Paditësit B.S. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€,
- Paditësit Xh.S. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€,
- Paditësit B.M., për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€,
- Paditësit D.Q. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 451€,
- Paditësit M.H., për 20 vite përvojë pune dy paga jubilarë në shumë prej 1086€ (2x543€),
- Paditësit R.R. për 30 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 1494€,

- g. Paditësit J.A. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€,
- h. Paditësit B.Ç. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€
- i. Paditësit F.S. për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumën prej 453€,
- j. Paditësit M.M., për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumën prej 453€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë datë 28.02.2020 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve lidhur me kompensimin e shujtave ditore për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 edhe atë për 1. Paditësit B.S. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 2. Paditësit A.R.1. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 3. Paditësit F.R. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 4. Paditësit Z.K. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 5. Paditësit Xh.S. për 206 ditë nga 2 euro shumën prej 412€, 6. Paditësit B.M., për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 7. Paditësit B.R. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 8. Paditësit A.Xh. për 208 ditë nga 2 euro shumën prej 416€, 9. Paditësit D.Q. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 10. Paditësit B.A. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 11. Paditësit M.H., për 200 ditë nga 2 euro shumën prej 400€, 12. Paditësit H.Rr., për 193 ditë nga 2 euro shumën prej 386€, 13. Paditësit R.R. për 196 ditë nga 2 euro shumën prej 392€, 14. Paditësit R.H. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 15. Paditësit J.A. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 16. Paditësit E.B., për 209 ditë nga 2 euro shumën prej 418 euro, 17. Paditësit B.Ç. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 18. Paditësit Xh.Q. për 191 ditë nga 2 euro shumën prej 382 euro, 19. Paditësit V.I. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 20. Paditësit F.J. për 203 ditë pune nga 2 euro shumën prej 406€, 21. Paditësit F.S. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 22. Paditësit M.M., për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, 23. Paditësit M.U., për 199 ditë nga 2 euro shumën prej 398€, 24. Paditësit H.O. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 25. Paditësit T.H., për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 26. Paditësit N.G. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 27. Paditësit T.I. për 201 ditë nga 2 euro shumën prej 402€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve F.M., F.R., Z.K., Xh.S., B.M., B.S., A.R.1., A.R.2., B.R., A.Xh., D.Q., N.G., B.A., M.H., H.Rr., R.R., R.H., J.A., E.B.,

B.Ç., Xh.Q., V.I., F.J., F.S., T.I., M.M., M.U., H.O. dhe T.H. kundër të paditurës Komuna Ferizaj.

IV. KONSTATOHET E TËRHEQUR PADIA e paditësve F.M. dhe A.R.2. e ushtruar kundër të paditurve Komuna Ferizaj dhe Qeveria e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme e Kosovës.

V. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale e paditësve, ashtu që **DETYROHET** e paditura Qeveria e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme e Kosovës, që paditësve të jau paguajë shpenzimet procedurale edhe atë shumën prej 912,00€, në afat prej 7 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, ndërsa **pjesa tjetër** në lartësinë prej 1248,00€ **refuzohet pjesërisht si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre zyra ligjore “Prof-H” H.Rr. nga Ferizaj, adresa rr. Dëshmorët e Kombit, Ferizaj, më 28.02.2020, kanë ushtruar padi kundër të paditurve, për shkak të mospërbushjes së obligimeve nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive dhe Vendimit të KK. Ferizaj 01.Nr.2889, vlera e kontestit mbi 35,000€. Në padi kanë theksuar se në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e paditura ka qenë e obliguar që paditësve t’ia kompensoj shujtën ditore dhe pagën jubilarë sipas përvojës së punës si dhe obligimet tjera të cilat burojnë nga kjo kontratë, të cilat asnjëherë nuk i ka përmbushur. Gjatë kohës së vlefshmërisë së kësaj kontrate e paditura ka qenë e obliguar që paditësve tua kompensoj shujtën për 36 muaj në shumë prej 2,00€ ditore ose 44€ në muaj, neni 54, pika 1 KPK si dhe një, dy apo tri paga jubilarë varësisht nga përvoja e punës, neni 52, pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 e KPK. Po ashtu në bazë të Vendimit të Kuvendit Komunal Ferizaj me nr. 01.nr.2889, të datës 04.07.2003 e paditura ka pasur për obligim që të paguaj shujtën ditore në vlerë prej 2,00€ mirëpo këtë obligim nuk e ka përmbushur. Në shqyrtimin gjyqësor, i autorizuari i paditësve Av. H.Rr. nga Ferizaj, e ka precizuar kërkesëpadinë sipas parashtrësës së dt. 22.12.2022 dhe parashtrësës për përmirësim të parashtrësës së dt. 05.03.2024, si dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë, kërkesëpadisë si dhe parashtrësës për precizim të kërkesëpadisë, me të cilën paditësit kanë kërkuar të detyrohet e paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave – Njësia e Zjarrfikësve në Ferizaj, që paditësve për

periudhën 01.01.2017-31.12.2017 t'ia pagu shumat si në vijim: 1. Paditësit B.S. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€ në total 863€, 2. Paditësit A.R.1. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 3. Paditësit F.R. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 4. Paditësit Z.K. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 5. Paditësit Xh.S. për 206 ditë nga 2 euro shumën prej 412€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€ në total 865€, 6. Paditësit B.M., për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€ në total 863€, 7. Paditësit B.R. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 8. Paditësit A.Xh. për 208 ditë nga 2 euro shumën prej 416€, 9. Paditësit D.Q. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€ në total 863€, 10. Paditësit B.A. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 11. Paditësit M.H., për 200 ditë nga 2 euro shumën prej 400€ për 20 vite përvojë pune dy paga jubilarë në shumë prej 1086 (2x543€) në total 1486€, 12. Paditësit H.Rr., për 193 ditë nga 2 euro shumën prej 386€, 13. Paditësit R.R. për 196 ditë nga 2 euro shumën prej 392€ për 30 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 1494€ në total 1876€, 14. Paditësit R.H. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 15. Paditësit J.A. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€ në total 863€, 16. Paditësit E.B., për 209 ditë nga 2 euro shumën prej 418 euro, 17. Paditësit B.Ç. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€, për 10 vite përvojë pune tri paga jubilarë në shumë prej 1359€ (3x453) në total 1769€, 18. Paditësit Xh.Q. për 191 ditë nga 2 euro shumën prej 382 euro, 19. Paditësit V.I. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 20. Paditësit F.J. për 203 ditë pune nga 2 euro shumën prej 406€, 21. Paditësit F.S. për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€, në total 863€, 22. Paditësit M.M., për 205 ditë nga 2 euro shumën prej 410€ për 10 vite përvojë pune një pagë jubilarë në shumë prej 453€, në total 863€, 23. Paditësit M.U., për 199 ditë nga 2 euro shumën prej 398€, 24. Paditësit H.O. për 203 ditë nga 2 euro shumën prej 406€, 25. Paditësit T.H., për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 26. Paditësit N.G. për 204 ditë nga 2 euro shumën prej 408€, 27. Paditësit T.I. për 201 ditë nga 2 euro shumën prej 402€, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i parashtrimit të padisë si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, konsiderohet e tërhequr padia për paditësit F.M. dhe A.R.2. pas që të njëjtit nuk kanë qenë të punësuar tek e paditura në vitin 2017. Lidhur me përvojën e punës së paditësve, e njëjta deshmohet nga lista e pagave dhe nga vërtetimi i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme-Agjencia e menagjimit emergjent-njesia e zjarrefikseve në Ferizaj në të cilën thuhet se me këtë vërtetim njesia e Zjarrefikseve Ferizaj paraqet vitet e përvojës së punës së zjarrefikseve si në listën e mëposhtme, ku me tej përshkruhet përvoja e punës për secilin paditës gjatë viteve referuese 2017-2022, është i paqëndrueshëm supozimi i

te paditures se pare, “se paditesit kane mundure te punojne diku tjeter” ndersa me asnje prove nuk deshmohe se te njejtit paraprakisht kane punuar ne ndonje instucion ose ndermmarrje tjeter. Sa i perket aktemrimeve te paditesve si ne shkresa te lendes e informojme gjykatën se keto akt emrime jane perpiluar karshi ndryshimit te rregullatives ligjore e qe nuk nenkupton se paditesit kane themeluar mardhenie pune tek e paditura me rastin e leshimit te ketyre aktemrimeve. Sa i perket kundershimit lidhure me shujtat ditore, duke u thirrur ne shtesat prej 30 euro te cilat kane marr paditesit e cila nuk eshte kontestuese, informojme gjykatën se kjo shtese eshte ndare per te gjithë sherbyesit civil ne nivel vendi ne vitin 2010 sipas vendimit te Qeverise se Kosoves me nr. 11/126, e dt.26.05.2010, e cila ka qene e dedikuar per vitin 2010 si shtese ndersa me nje vendim te mevonshem eshte vendosur qe kjo shtese te mbetet si nje rritje page ne menyre lineare per te gjithë sherbyesit civil te Kosoves. Prandaj, kjo nuk llogaritet si shtese mbi page por ka qene pjese e pages qe nga viti 2010, e cila krahas rritjes se pages nder vite edhe kjo shtese eshte rritur (shih rritjen nga 30 ne 31.20) po te konsiderohet si shtese mbi page atehere nuk do te kishte kuptim dispozita e kontrates se pergjithshme kolektive per shujta per faktin se kjo shtese figuron ne listen e pagave qe nga viti 2010, ndersa kontrata e pergjithshme kolektive ka qene ne fuqi nga janar 2015. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësve ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëadisë së precizuar si dhe thënieve në seancën e sotme, pas administrimit të provave është provuar në mënyrë të pakontestueshme baza juridike e paditësve lidhur me kërkesat e tyre për shujtat ditoree dhe shpërblimet jubilarë, në parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë kemi pasur parasysh që të përfshihen vetëm ato kërkesa të cilat nuk janë parashkruar, si dhe për shpërblimet jubilarë vetëm për ata paditës që kanë plotësuar kushtet ligjore, andaj kërkojmë nga gjykata që të njejten ta aprovoj si të bazuar në tërësi, e paditura nuk ka paraqitur asnjë provë materiale me të cilën do të mund ta kundërshtoj apo provoj të kundërtën. Andaj i kërkoj edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2160 euro, 101 euro per takse, 624 per padi, 624 per parashtrësen per precizim dhe 811 euro per seancen e sotme. Lidhur me kontestimin e legjimitetit pasiv real te mebetet ne diskrecionin e gjykates te vendose mbi pergjegjesinë financiare për permbushjen e detyrimeve.

E paditura Komuna Ferizaj në përgjigje në padi të dt. 02.06.2020 dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se mbetemi në tërësi si në përgjigje në padi, duke kundërshtuar pretendimet e paleve paditese se per kompensim te shujtes ditore dhe pagave jubilarë, lidhur me kompensimin e shujtes ditore dispozita e nenit 54 ka percaktuar se kur punëtoret kane te drejte ne kompesimin e shpenzimeve te ushqimit, ne lartesi prej 2 euro, meqenëse nga listat e pagave vertetohet fakti se paditesit kane shtesa mbi

pagen baze dhe neni 54 paragrafi 2, i marreveshjes se pergjithshme kolektive te Kosoves, ka percaktuar se aty ku nuk ka shtesa mbi pagen baze e ka mundesi financiare munde te paguhet kompensimi per ushqim gjate orarit te punes. Sa i perket shperblimit te pagave jubilarare une i kundërshtoj shperblimin e pagave jubilarare se duhet te jete pervoja e punes pa nderperere ne institucionin perkates. Ne baze te provave materiale qe ekzistojne ne shkresa te lendes gjegjesisht aktemërimet asnje padites nuk i ploteson kushtet per page jubilarare ngase nuk kane provuar me prova materiale se në këtë institucion jane ne marrëdhënie pune 10 vite e me shume ne kohe te pandërprere. Marreveshja e pergjithshme kolektive ka hy ne fuqi me dt 01.01.2015 dhe eshte shfuqizuar 31.12.2017 per kete çështje kemi mendimin juridik te Gjykate Supreme qe ka te beje me marreveshjen kolektive nga e cila burojne te drejtat e puntoreve. Edhe me tutje e paditura e konteston legjitimitetin real pasiv te saj, meqense Institucioni i zjarrefikseve eshte ne menaxhimin e MPB-Agjenicia per menaxhimin e zjarrefikësve. Nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura Qeveria e Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave përmes avokaturës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë e Kosovës, në përgjigje në padi të dt. 18.06.2020 dhe shqyrtimin gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se në bazë të Ligjit nr. 04/L-049 për Zjarrfike dhe Shpëtim, neni 7 përcaktohet se: “1. Njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, janë staf i ministrisë dhe menaxhohen nga agjencia në bashkëpunim dhe koordinim me komunat”. Mirëpo mjetet buxhetore (pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, kapitalet dhe subvencionet, për këto njësi vazhdojnë edhe sot e kësaj dite të menaxhohen nga vet Komuna. Andaj të gjitha obligimet financiare për këtë kategori në nivel vendi vazhdojnë të jenë përgjegjësi e nivelit lokal. E konteston në tërësi vendimin 01 nr. 2889 të dt. 04.07.2003 të Kuvendit Komunal Ferizaj ku parashihet kompensimi i punonjësve. Pretendon se ekziston parashkrimi i kërkesës. Paditësit nuk i kanë shterur procedurat e brendshme brenda institucionet të paditurës, lidhru me këtë çështje kontestuese. Marrëveshja e përgjithshme kolektive e Kosovës nuk është në fuqi nga dt. 31.12.2017 ndërsa padia e paditësve është dorëzuar në gjykatë më 2020 dhe nsi e tillë asnjë dispozitë e kësaj kontrate nuk ka paraparë veprim retroaktiv.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Vendim i kuvendit komunal Ferizaj, 01.nr.2889, dt. 04.07.2023, Akt emrim i paditësit R.R. i dt.01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditësit H.O. i dt.

01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit F.R. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Kontrate pune per kohe te pacaktuar e paditesit F.M. e dt. 25.03.2019, e lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë, Ndryshimi i Akt emrimit i paditesit Xh.S. i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit M.M. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit T.I. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Kontrate e mardhenies se punes e paditesit T.I., me nr. 284/2009, e lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit F.S. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit F.J. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit V.I. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Ndryshimi i akt emrimit te paditesit Xh.Q. i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit B.Q. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit E.B. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit J.A. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit H.Rr. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe dy ndryshime te aktit te emrimit të datave 01.08.2013 dhe 02.06.2014 të lidhura mes paditësit dhe të paditurës së dytë, Akt emrim i paditesit R.H. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit M.H. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit B.A. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Ndryshimi i aktit te emrimit i paditesit D.Q. i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit A.Xh. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i aktit te emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Kontratë pune për kohë të pacaktuar e dt. 25.03.2019 e lidhur mes paditësit A.R.2. dhe të paditurës së dytë, Akt emrim i paditesit B.R. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Akt emrim i paditesit A.R.1. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Ndryshimi i Akt emrimit i paditesit Xh.S. i dt 01.08.2013 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit B.S. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Ndryshimi i akt emimrit i paditesit Z.K. i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit B.M. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes

paditësit dhe të paditurës së parë, Kontrat e mardhenies se punes se paditesit T.H. me nr. 195/2010 e lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë dhe ndryshimi i akt emrimit i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së dytë i dt. 01.08.2013, Akt emrim i paditesit N.G. i dt. 01.07.2011 i lidhur mes paditësit dhe të paditurës së parë, Listat e pagave të paditesve te muajit janar 2020, Vertetimi i viteve te përvojës së punes i leshuar nga Komandanti i Zjarrefiksve ne Ferizaj – Njesia e Zjarrefiksve dhe Vertetimi i diteve te punes i leshuar nga Komandanti i Zjarrefiksve ne Ferizaj –Njesia e Zjarrefiksve.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Zbatimi i së drejtës materiale

Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e datës 18.03.2014, e lidhur nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), saktësisht neni 4 thotë: “1.Dispozitat e MPKK i obligojnë punëdhënësit të cilët, në çfarëdo mënyre, kryejnë veprimtari ekonomike, joekonomike dhe shërbime civile. Marrëveshja Kolektive, mund të lidhet edhe në nivel të Degës dhe të Ndërmarrjes. 2.Degët e sindikatave të veprimtarive joekonomike (shërbimet civile, publike dhe ndërmarrjet publike), lidhin kontratë të posaçme me punëdhënësit e tyre (ministritë përkatëse, atë të Administratës Publike, Arsimit, Shëndetësisë, etj), në pajtim me specifikat e tyre.” Neni 43.6 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të lartë cituar përcakton se: “6.Të punësuarit, mund ti njihet e drejta në bonuse dhe stimulime tjera në punë, përfshirë edhe pagën e trembëdhjetë (13), në pajtim me mundësitë materiale për pagesat e tilla.” Neni 54 i po kësaj marrëveshje poashtu parashikon se: “1.Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. 2.Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës. 3. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim.” Sipas nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të lartcitar, parashihet që: “Neni 52 Shpërblime

jubilare 1. I punësuar, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.”.

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme e Kosovës nr. 40/2023, i datës 27.02.2023, pika II. parasheh se: "Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015-31.12.2017.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 21-2012-MPB për Transferin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit nga Komunitat në MPB-AME, neni 2 thuhet se: “Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ përcaktojnë se Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, janë staf i MPB-së dhe menaxhohen nga AME në bashkëpunim dhe koordinim me komunitat.”, neni 4 thuhet se: “Pjesëtarët e NJPZSH-së sipas Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim, janë staf profesional i MPB-së dhe menaxhohen nga AME në bashkëpunim dhe koordinim me komunitat.”, neni 5 thuhet se: “1. Transferimi i SHZSH-së bëhet së bashku me tërë personelin, pajisjet dhe mjetet e saj transferohen nga komuna në MPB- AME. 2. Komuna do t’i dorëzojë MPB-AME komplet dokumentacionin e shërbimit aktual të ZSH-së, të cilat do të pranohen nga Komisioni i themeluar me vendim të MPB për këtë qëllim. 3. Komisioni nga paragrafi 2 i këtij neni përbëhet nga dy anëtar të MPB- AME-së dhe përfaqësuesi i komunës përkatëse.”, neni 7 thuhet se: “Buxheti aktual i planifikuar nga komunitat për shërbimin aktual të SHZSH nga momenti i transferimit menaxhohet nga MPB-AME”.

Vlerësimi i provave

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në këtë shqyrtim gjyqësor, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar sa i përket shpërblimit jubilar ndërsa e pabazuar në raport me kërkesën për shpërblimin e shujtave ditore.

Gjykata vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve kundër të paditurës Komuna Ferizaj sepse Komunës së

Ferizajt i mungon në tërësi legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë sepse në bazë të ndryshimit të aktemërimit të paditësve rezulton që kanë kaluar nga Komuna Ferizaj në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent në kuadër të MPB-Qeveria e Kosovës, në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 21-2012-MPB për Transferin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit nga Komunitat në MPB-AME. Sipas nenit 7 të këtij udhëzimi, parashihet që: “Buxheti aktual i planifikuar nga komunitat për shërbimin aktual të SHZSH nga momenti i transferimit menaxhohet nga MPB-AME”. Andaj mbi këtë bazë juridike u refuzua në tërësi kërkesëpadia e paditësve në raport me të paditurën Komuna Ferizaj. Me leximin e ndryshimit të aktemërimeve të cilat gjenden në shkresat e lëndës për paditësit, në këto aktemërime në referat të tyre përshkruhet se: “Paga mujore do të merret nga buxheti komunal deri me transferimin e mjeteve buxhetore nga niveli lokal (komunitat) në nivelin qendror / MPB – AME. Punëmarrësi ka të drejtë në pagën bazë dhe shtesa në pagën bazë. Paza bazë dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e caktuara në ligjin në fuqi dhe me akte nënligjore. Paga e punëmarrësit përbëhet nga paga bazë (në përqindje ose në shumë absolute) me karakter të përhershëm. Koeficienti i pagës mbetet i njëjtë etj..). Vlen të ceket se konform nenit 329.1 të LPK, parashihet që: “329.1 Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”. Andaj aktemërimeve, ndryshimit të aktemërimeve, kontratës së punës, listës së pagave etj. Gjykata ja fali në tërësi besimin sepse janë shkresa të cilat i ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës dhe me to provohet saktësia e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.

Lidhur me lartësinë e shumave të kërkesave të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata u mbështet në listat e pagave të buxhetit të RKS, të administruara si provë në këtë shqyrtim gjyqësor.

Lidhur me bazën juridike të aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve lidhur me shpërblimin jubilar, gjykata u mbështet në dispozitat e nenit 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, duke u bazuar edhe në faktin që në bazë të përvojës së punës të shprehur në listat e pagave të buxhetit të RKS del që në kohën e arritjes së jubileut të punësimit marrëveshja e përgjithshme kolektive ishte në fuqi, ashtu që bazuar mbi këtë fakt, rezulton i drejtë përfundimi që kërkesëpadia e paditësve për këtë pjesë është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet me

vendim të gjykatës. Ndërsa nuk ka parashkrim të kërkesëpadi së për këtë pjesë sepse kërkesëpadi është parashtruar brenda afatit 3 vjeçar nga koha e arritjes së jubileut.

Gjykata vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me ç’rast e ka konstatuar si të tërhequr padinë e paditësve F.M. dhe A.R.2. për të gjitha kërkesat, në përputhje me nenin 261, par. 2 lidhur me par. 1 të LPK.

Gjykata vendosi si në pikën IV. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me shpërblimin e shujtave ditore. Nga provat e administruara, por edhe nga pohimi i palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se paditësit janë duke punuar në Sektorin e Shërbimit të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, në cilësinë e zjarrfikësve. Sipas listës së pagave të paditësve të muajit janar 2020, rezulton se paditësit kishin pranuar si shtesë në pagë shumën prej 31,2€. Kurse sipas dispozitës së nenit 54.2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës parashihet qartë se: “Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës”, që nënkupton se aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë (që nuk vlen për rastin konkret) dhe ka mundësi financiare mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës, ndërsa paditësit kanë pranuar shtesa mbi pagën bazë dhe ky nuk është fakt kontestues mes palëve dhe paditësit asnjëherë nuk e mohuan këtë fakt.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale dhe ka shqyrtuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse (gojore dhe atyre me shkrim), por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjykata e ka detyruar të paditurën Qeveria e Kosovës – MPB, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave që paditësve të jau kompensoj shpenzimet procedurale në lartësi prej 912,00€ edhe atë për taksën për padi 101€ dhe për përfaqësim në një seancë 811€. Ndërsa shpenzimet në shumën prej 624€ në emër të hartimit të padisë janë refuzuar sepse në bazë të leximit të referatit të padisë rezulton që padia nuk është hartuar nga ana e avokatit sepse nuk përmban vulë dhe firm të avokatit, ndërsa shpenzimet në shumën prej 624€ në emër të parashtrësës për precizim të padisë refuzohen poashtu sepse parashtrësja për precizim të padisë nuk hyn në grupin e parashtrësve për të cilat është e detyruar të paguhet kompensimi.

Andaj, bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.475/20, datë 05.06.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit e Kosovës, e përmes të kësaj gjykate.